

V E N D I M
Nr.366 datë 21.7.1993

PËR KRIJIMIN E QENDRËS PËR MANAXHIMIN DHE ADMINISTRIMIN PUBLIK

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Qendrës për Manaxhimin dhe Administrimin Publik. Qendra zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të statutit që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 1993, Ministria e Arsimit dhe Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë të paraqesin për miratim statutin e veprimtarisë së Qendrës.

2. Ministria e Arsimit dhe Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë brenda muajit korrik 1993, t'i paraqesin Kryesisë së Këshillit të Ministrave propozimin për emërimin e drejtorit të Qendrës.

3. Për mbështetjen e veprimtarisë së Qendrës, për vitin 1993 jepen 200.000 lekë që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në Buxhetin e Shtetit për këtë vit.

4. Për fillimin e veprimtarisë së Qendrës, Fakulteti i Ekonomisë dhe i Biznesit të Universitetit të Tiranës të sigurojë mjedisin e përshtatshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Komiteti i Shkencës dhe i teknologjisë.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.193, datë 29.4.1993 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi